



## MEMORANDUM I MIRËKPUTIMIT

në mes të:

UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN

DHE

ROMA VERSITAS KOSOVO (RV Kosovo)

Për

**Mbështetje për arsimimin e mëtejshëm të studentëve nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptjan në Kosovë**

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejshëm Memorandumi i Mirëkuptimit) konfirmon që partnerët e cekur më lartë, Universiteti "Ukshin Hoti" me seli në Prizren rr. Rruga e Shkronjave p.n dhe OJQ lokale Rome Versitas Kosova (RV Kosovo) me seli në Prishtinë rr. Robert Doll Nr, 6, Kati - 1, Hyrja - 1. (Lagjja Dardani) Prishtine 10000, Kosovo dëshirojnë të bashkëpunojnë dhe të mbështesin arsimimin e mëtutjeshëm të studentëve nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptjanë (por pa u kufizuar në) në Kosovë. Qëllimi i këtij Memorandumi është të risë normën e vijueshmërisë dhe kapacitetet personale të studentëve të komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan në Kosovë dhe t'i mbështesë ata për arsimim të mëtejshëm.

### Neni 1

#### Arsyetimi për bashkëpunimin

1. Përmes këtij Memorandumi, palët shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar brenda kuadrit të objektivave të projektit dhe mundësive të tyre ligjore dhe buxhetore.
2. Bashkëpunimi synon të krijojë mundësi më të mira arsimore për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptjan (në tekstin e mëtejshëm RAE) në Kosovë, për të mbështetur arsimimin e mëtejshëm të komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan në Kosovë, për të ngritur rrjetin dhe lobim më të mirë për të mbështetur arsimimin e komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan në Kosovë dhe për të krijuar një mjedis më mirë arsimor për ta.
3. Palët do të mbështesin komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan në Kosovë në aktivitete, projekte dhe programe të ndryshme (ose në formë tjetër) vetëm me marrëveshje të përbashkëta me shkrim.
4. Roli dhe përgjegjësia e secilës palë duhet të përcaktohen qartë dhe të miratohen gjithmonë me shkrim.



## **Neni 2 Kontributi i partnerëve**

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, dhe Roma Versitas Kosova (RV Kosova) në bazë të këtij Memorandumi do të:

- a) Ndajnë dhe informojnë njëri-tjetrin në mbështetje të edukimit të mëtejshëm të studenteve të komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan në Kosovë.
- b) Shkëmbimin e programeve dhe projekteve me marrëveshje reciproke me interes në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe arsimimit të studentëve nga komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan në Kosovë.
- c) Të krijojnë mundësi për tubime dhe bashkëpunim të stafit akademik, studentëve aktualë ose potencialë, prindërve dhe akterve të tjerë të rëndësishëm për të ngritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e arsimimit dhe edukimit të mëtejshëm të komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan dhe t'u mundësojnë atyre takime sipas nevojave të tyre.
- d) Kooperim në aktivitete dhe bashkëpunime profesionale përfshirë hulumtimet, trajnimet e përbashkëta, punëtoritë, kurset e anglishtes, seminarët dhe konferencat të ndryshme;
- e) Mbështesin njëri-tjetrin në fushën e promovimit të ideve të tyre në dobi të studentëve nga komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptjan zhvillimin e aktiviteteve në dobi të komuniteteve dhe mbështetje tjetër administrative dhe logjistike kur partnerët kanë mundësi me kërkesë me shkrim të aprovuar paraprakisht.

## **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është 3 (tre) vite, me efekt nga data e nënshkrimit të këtij Memorandumi.

## **Neni 4 Shkëputja/Ndërprerja**

Të gjitha palët do të kenë të drejtën ta përfundojnë/ndërprejnë këtë Memorandum, duke i dhënë palës tjetër 30 ditë njoftimit me shkrim në rast se:

- a) Kanë dallimet ideologjike të papajtueshme midis palëve
- b) Keqpërdorimi i burimeve financiare nëse / kur është e aplikueshme, apo aseteve të ndonjëres nga palët
- c) Mungesë e bashkëpunimit nga secila palë
- d) Paafërsia për të kryer aktivitetet sipas marrëveshjeve të veprimtarisë së dakorduar me shkrim

## **Neni 5 Procedura e daljes**

Të gjitha palët duhet të angazhohen që zyrtarisht t'i komunikojnë njëri tjetrit nëse dëshirojnë të vazhdojnë Memorandumin e Mirëkuptimit ose nuk duan të vazhdojnë marrëdhëniet në fund të këtij Memorandumi.



ROMA  
VERSITAS  
KOSOVO



**Neni 6**  
**Vlefshmëria e këtij Memorandumi**

1. Ky Memorandum do të jetë i vlefshëm që nga dita kur ajo nënshkruhet nga të gjitha palët.
2. Memorandumi i Mirëkuptimit do të shtypet në katër kopje në gjuhën Shqipe, dy kopje për secilin palë.

Palët pajtohen me këtë Memorandum të Mirëkuptimit me nënshkrimet e tyre më poshtë:

Datë: 04.04.2024

Në emër të UPZ

Prof. Mentor Alishani,  
Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti"



Në emër të RV Kosova

Fallum Kryeziu,  
Menaxher i programit